  d) Të hyrat e shtyera,
  e) Analiza e sezonit 2022 /2023,
  f) Raporti i Leximit i konsumit të energjisë (tetor 2022 – prill 2023),
  g) Raporti i investimeve me vetfinancim (maj 2022-prill 2023),
  h) Gjendja e aseteve 30.04.2023,
  i) Pasqyrat financiare 2022,
  j) Raporti i Auditorit për vitin 2022.

- Njoftimin për emërimin e drjetorit te departamentit Administrativ.
- Draft - Raportet për Aplikim për shqyrtim tarifor për sezonin ngrohës 2023/2024.
  a) Raportet e detajizuara për shqyrtimin tarifor për sezonin 2023/2024,
  b) Pasqyrat Rregullative me të dhëna të planifikuara për sezonin 2023/2024,
  c) Shpalosjen e Pasqyrës B.

Nga ZRRE kemi pranuar :

- Komentet për Bilancin Vjetor të energjisë termike 2023.
- Vendimin e Bordit të ZRRE, V_1665_2023" me të cilin aprovohet -Amandamentimi i "Marrëveshjes për furnizim me ngrohje " e lidhur me datën 24.12.2014, nr. 252 në mes KEK – Korporata Energjetike e Kosovës sh.a dhe NP "Termokos"sh.a dhe "Aneks- Marrëveshja për caktimin e çmimit të energjisë termike nga koogjenerimi për sezonin ngrohës 2022 /2023".
- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka publikuar për diskutim publik Bilancin vjetor 2023 të NP"Termokos"sh.a
- Njoftimin, planin e zbatimit dhe kërkesën për dërgimin e raporteve me të dhëna të parashikuara për sezonin 2023/2024, në kuadër të shqyrtimit të tarifave të energjisë termike për sezonin e ngrohjes 2023-2024 të NP Termokos SH.A.

Në Ministrinë e Ekonomisë- ME është dërguar:

- Formulari i plotësuar nga NP"Termokos"sh.a, më të dhënat e kërkuara mbi projektet e financuara nga donatorët dhe kreditë gjatë periudhës 2018-2022.
- Formularët e rishikuar PIF te projekteve të Termokosit, të përmirësuara sipas komenteve të dhëna nga ekspertët, lidhur me rishikimin e projekteve në kuadër të LPP-së.
- Draft- Bilancin vjetor për vitin 2023 dhe tabelarët përkatës, të përmirësuar sipas komenteve të dhëna nga ME dhe ZRRE
- Raportet për projektet të cilat janë zbatuar gjatë vitit 2022, me të dhënat për projektet e realizuara me IPA 2015, nga NP"Termokos"sh. A.
- Vendimi i ZRRE-se nr.V_1703 2023 per aprovimin e Bilancit te energjise termike per vitin 2023.
- Në draft dokumentin " Planit Kombëtar të Veprimit për Efiçiencë të Energjisë 2022-2025 "të V-të, janë përditësuar të dhënat lidhur me projektet e NP"Termokos"SH.A., si dhe janë dhënë komente në pika të caktuara të këtij dokumenti.
- Përgjigja nga Termokosi lidhur me raportin e Planit të Veprimit Agjenda për Reforma Evropiane (ERA) II për periudhën K1 2023.
- Tabelari i plotësuar me të dhënat e kërkuara rreth projekteve investive të Termokosit të implementuara në vitin 2022, të cilat kanë ndikim në efiçiencë të energjisë.
- Raporti i përditësuar me të dhëna për projektet e Termokosit, përkitazi me raportin për Planin e Veprimit ERA II për periudhën K2 2023.
- Raporti i përditësuar me të dhëna për projektet e Termokosit, lidhur me rishikimin e Planit Kombëtar për Zhvillim 2023-2025, për periudhën janar-qershor 2023.

Nga Ministria e Ekonomisë- ME është pranuar:

- Kërkesa lidhur me përgatitjen e të dhenave për projektet të cilat kanë financim vetëm nga donatorët e jashtëm duke përfshirë edhe kreditë për periudhën 2018-2022.
- Komentet nga ekspertët e angazhuar nga Zyra e Kryeministrit të Kosovës -ZKM lidhur me formularët e rishikuar PIF të projekteve të Termokosit, në kuadër të LPP-së.
- Kërkesën e ZKM, për plotësimin e raporteve për projektet e zbatuara gjatë vitit 2022, përfshirë ato projekte që kanë filluar më herët dhe kanë përfunduar zbatimin gjatë vitit 2022, me qëllim të hartimit të raportit vjetor për zbatimin e IPA-s.
- Ftesën për pjesëmarrje në një punëtori treditore (20 - 22 Mars 2023) , si anëtare e grupit punues për hartimin e "Planit Kombëtar të Veprimit për Efiçiencë të Energjisë V-të".
- Ftesën për pjesëmarrje në takim, ku do të prezantohen projektet e Listës Prioritare të Projekteve Infrastrukturore (LPP) për fushën e energjisë, para partnerëve zhvillimorë.
- Kërkesën për të dhënat për projektet e Termokosit, lidhur me raportin e Planit të Veprimit Agjenda për Reforma Evropiane (ERA) II për periudhën K1 2023.
- Kërkesën për plotësimin e tabelarit, me të dhëna rreth projekteve investive të implementuara në vitin 2022 të cilat kanë ndikim në efiçiencë të energjisë.

Në Agjensionin e Statistikave të Kosovës (ASK) kemi dërguar:

- Të dhënat teknike në bazë mujore për vitin 2022, si indikatorë të nevojshëm për hartimin e bilancit me përgatitjen e Bilancit të Energjisë në Kosovë.
- Pyetesoret me pergjigjet e kerkuara për TM1 dhe TM2/2023.

Inspektimi, mbrojtja dhe siguria në punë

Në kuadër të mbikëqyrjes / inspektimit të aktiviteteve të mbrojtjes dhe sigurisë në punë dhe MKZ-së, gjatë periudhës raportuese janar-qershor 2023, janë realizuar këto aktivitete:

- Furnizimi me rroba dhe këpucë pune për të gjithë punonjësit të cilët duhet ti kenë Mjetet Mbrojtëse të punës.
- Kujdesi për mbrojtjen dhe sigurinë në punë të personelit, duke bërë kontrolla të vazhdueshme, se a po përdoren rrobat e punës dhe mjetet mbrojtëse në punë. Po ashtu bëhen edhe inspektime në vendpunishte për të parë nga afër se apo punohet me standarde dhe në pajtueshmëri me Ligjin 04/L-161.
- Është mbajtur evidence e saktë e mjeteve mbrojtëse në punë, paisjeve kundër zjarrit dhe në bashkëpunim të ngushtë me menagjmentin, është inspektuar zbatimi i masave për mbrojtjen në punë.
- Angazhimi në komisionin vjetor për regjistrim e mjeteve themelore dhe invertarit.
- Menaxhimi i projektit për furnizim me Oksigjen, Acitilen dhe Gas Butan .
- Hartimi dhe dërgimi i kërkesë tek Menaxhmenti për përgaditjen e Elaboratit për Mbrojtje Kundër Zjarrit ,për Rezervuaret e Mazutit dhe Kaldajave Angazhimi në komisionin vjetor për regjistrim e mjeteve themelore dhe invertarit.
- Angazhimi në komisionin për shitjen e mbeturinave të hekurta.
- Është përgatitur specifikacion teknik për furnizimin me aparate të reja kunder zjarrit - AKZ, për instalimin e detektorve të tymit në HES (Kosova B) dhe për servisim e AKZ dhe Hidrantave ekzistues.
- Në bashkpunim me Menaxherin e Projektit janë mbikqyr punët sipas marveshjes së nënshkruar me O.E "Proglobal" për M.K.Z
- Punonjësit të cilët nuk i përdorin PPM ju terhiqet vrejtja dhe paralajmrohen për masat të cilat merren ne rast se prap hasen pa PPM.
- Për punë më siuri më të lartë dhe me standarde, për sezonen 2022-2023 kemi planifikuar që të blihen paisje si në vijim: dërrasa, shtylla, shatora, reflector për ndriqim, ventilator për thithjen e avullit nga pusetat, rrethoja për rrethimin e vendëpunishtes , shenja paralajmruese për vendpunishte, drita reflektuese, kona etj.
- Kemi planifikuar të bëhet vlerësimi i rrezikshmerisë për të gjitha vendet e punës, po ashtu kemi planifikaur: Trajnimin e përgjithshëm për Siguri dhe Shëndet në Punë për të gjithë punonjësit, Trajnimin për dhënjen e Ndihmës së Parë si dhe Kontrollen Sistematike .
- Rreziku nga Covid 19 dhe nga insektet e brejtësit e ndrsyhëm, kemi paraparë që të bëhet Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi për të gjithë hapsirat punuese të ndërmarrjes.
- Është përfundu rregullorja e Brendshme për Siguri dhe Shëndet në Punë.

Mbrojtja Kundër Zjarrit - MKZ

Sa i përket Mbrojtjes Kundër Zjarrit (MKZ), gjate epriudhes raportuese janar-qershor 2023, jane zhvilluar keto aktivitete:


- Kujdesi për mbrojtjen dhe sigurinë në punë të personelit duke bërë kontrolla të vazhdueshme, se a po përdoren rrobat e punës dhe mjetet mbrojtëse në punë nga personeli .
- Është mbajtur evidence e saktë e mjeteve mbrojtëse në punë, paisjeve kundër zjarrit dhe ka bashkëpunuar ngushtë me menagjmentin , që zbatimi i masave për mbrojtje në punë të jetë i rregullt.
- Në bashkëpunim me mirëmbajtësit e oborrit të Termokos SH.A. jemi kujdesur për hapsirat gjelbëruese si dhe mirëmbajtjen dhe pastrimin e të gjithë hapsirës;
- Kemi menaxhuar shitjen e mbeturinave të hekurta (gypa) - projekt menagjer;
- Është kryer dezinfektimi dhe Deratizimi i të gjitha objekteve;
- Janë kontrolluar, servisuar dhe mbushur Aparatet Kundër Zjarrit;
- Është bërë kontrollë e vazhdueshme për ndalimin e pirjes së duhanit në ambiente të mbyllura; etj.

Investimi më i madh në Kosovë në sistemin e ngrohjes qendrore që nga vitet e 70-ta

Në kuader të përmirësimit të sistemit të ngrohjes qendrore, janë investuar mbi **Eur 37.1 mil.** Financimi i projektit të kogjenerimit është bërë nga Bashkimi Evropian Eur 13.8mil, Qeveria Gjermane & KfW Eur 15.0 mil., Qeveria e Luksemburgut Eur 1.5 mil., Qeveria e Suedisë Eur 1.9 mil., Qeveria e Kosovës Eur 1.2 mil dhe Komuna e Prishtinës Eur 3.8mil.

Skema e funksionimit të sistemit të koogjenerimit


Figura 2. Skema e funksionimit të sisitemit të koogjenerimit




Në janar-qershor 2023, energjia termike e prodhuar është

199,865.0 MWht

Figura 3. Bruto prodhimi i energjisë termike MWh i planifikuar dhe realizimi %





Departamenti i Prodhimit-Koogjenerimit

Në këtë raport gjashtëmujor të departamentit janë të paraqitura në formë tabelare dhe grafike të dhënat teknike. Në pasqyrën teknike janë të përfshira shifrat kyçe teknike: gradët ditore, temperaturat mesatare mujore, energjia termike e marrë nga KEK-u, humbjet e ujit, shpenzimet e kripës, shpenzimet e energjisë elektrike. Po ashtu, në këtë raport janë paraqitur aktivitetet e realizuara nga plani aksional 2023, i tre Divizioneve të Departamentit të prodhimit –koogjenerimit, respektivisht, Divizioni i makinerisë, Divizioni i elektrikës dhe Divizioni i PKU-së.
Në fund është bërë një përmbledhje e aktiviteteve, të cilat janë zhvilluar në janar-qershor 2023.

Prodhimi i energjisë termike

Në periudhën raportuese janar-qershor 2023, energjia termike e prodhuar në KEK është 199,817 MWht. Ndërsa, prodhimi i energjisë termike nga lënda djegëse mazut është 43.03 MWh. Total energjia termike e prodhuar në janar-qershor 2023 është 199,865 MWht. Krahasuar me planin 2023, është realizuar **108%.**

Humbjet në rrjetin e transmisionit

Në janar-qershor 2023, humbjet e energjisë termike në rrjetin e transmisionit – koogjenerimit nga stacioni HES-Obiliq deri në stacionin HRS-Termokos janë 3,997.3 MWht apo 2%.

Konsumi vetanak

Konsumi i energjisë termike për nevoja vetanake gjatë periudhes raportuese janar-qershor 2023, është 537.6 MWht.

Bruto dhe Neto prodhimi i energjisë termike gjatë periudhën raportuese janar-qershor 2023


Tabela 11. Bruto prodhimi i energjisë termike (MWh)

Muaj	Bruto prodhimi energj. termike	Humbjet në transportit	Konsumi Vetanak	Neto Prodhimi i ener.termike
	A	B	C	D=A-B-C
Janar	55,750.0 MWh	1,115.0 MWh	163.4 MWh	54,471.6 MWh
Shkurt	52,065.0 MWh	1,041.4 MWh	141.5 MWh	50,883.1 MWh
Mars	51,911.0 MWh	1,038.2 MWh	130.2 MWh	50,742.6 MWh
Prill	40,134.0 MWh	802.7 MWh	102.5 MWh	39,228.8 MWh
Maj	.0.0 MWh	0.0 MWh	0.0 MWh	0.0 MWh
Qershor	0.0 MWh	0.0 MWh	0.0 MWh	0.0 MWh
Total	**199,865.0 MWh**	**3,997.3 MWh**	**537.6 MWh**	**195,330.2 MWh**

Bruto prodhimi i energjisë termike krahasuar me periudhën e njëjtë të dy viteve paraprake

Bruto prodhimi i energjisë termike në janar-prill 2023 krahasuar me periudhën e njëjtë të dy viteve paraprake.


Figura 4. Energjia bruto e prodhuar në Janar-qershor/2023, 2022, 2021



Në përiudhen Janar-Qershor 2023 energjia bruto e prodhuar, krahasuar me gjashtemujorin e pare te vitit paraprak 2022, është më e madhe për **17,658 MWh** ose **9.7%**. Ndërsa, krahasuar me janar-qershor/2021, bruto prodhimi i energjisë termike në janar-qershor/2023 është më i madh për **15,090 MWh** apo **8.2%**.

Raporti në mes të energjisë termike të planifikuar (Ep=185,249MWh) dhe enrgjisë termike të realizuar (Er=199,865) në janar-qershor 2023, diferenca (ΔE=Er-Ep) është 14,615MWh. Pra, është realizuar **107.9%** nga plani për prodhimin e enrgjisë termike.

Humbjet e ujit në janar-qershor 2023, krahasuar me janar-qershor 2022, janë më të vogëla për 15.7%. Ndërsa, krahasuar me janar-qershor 2021, janë më të vogëla, për 22%. Pjesa më e madhe e këtyre humbjeve i referohet mbushjeve të shpeshta të rrjetit sekondar në objektet e reja dhe në objektet e vjetra, aty ku jane instaluar nënstacione të reja. Meqenëse, SCADA e nënsacioneve, për arsye të ndryshme, ende nuk është funksionalizuar tëresisht, nuk kemi evidencë të saktë për sasinë e ujit të futur në rrjetin sekondar.




Raporti mbi humbjet e ujit, shpenzimet e energjisë elektrike dhe shpenzimet e kripës në periudhen raportuese janar-qershor 2023

Të dhënat mbi humbjet e ujit, shpenzimet e energjisë elektrike si dhe shpenzimet e kripës nëpër muaj janë si vijon:

Humbjet e ujit

Humbjet e ujit në rrjetin e distribuimit në periudhën janar-qershor 2023 janë 39,311 m^3. Ndërsa në rrjetin e koogjenerimit janë 480 m^3. Total humbjet e ujit në rrjetin e distribuimit dhe atë koogjenerimit në janar-qershor 2023 janë 39,791 m^3. Krahasuar me periudhë e njëjtë të vitit paraprak janar-qershor 2022, kemi zvogëlim të humbjeve të ujit për 7,337 m^3 apo 16%. Ndërsa, krahasuar me janar-qershor 2021, humbjet në këtë periudhë janar-qershor 2023, janë më të vogëla për 11,103 m^3 respektivisht 22%.

Figura 5. Humbjet e ujit m^3 gjatë periudhës janar-qershor 2023, krahasimi me janar-qershor 2022 dhe janar-qershor 2021



Shpenzimet e energjisë elektrike

Në periudhën raportuese janar-qershor 2023, shpenzimi i energjisë elektrike në ngrohtore është 4,399.64 MWh, përderisa në nënstacione është 1,437.67 MWh. Shpenzimet e përgjithshme të energjisë elektrike gjatë periudhës raportuese, janë 5,837.31 MWh.

Shpenzimet e kripës

Shpenzimet e kripës për përgatitjen kimike të ujit për ngrohje gjatë periudhes raportuese janar-qershor 2023 janë 46,050 kg.

Tabela 12. Tabela përmbledhëse e humbjeve të ujit, shpenzimeve

2023	Humbjet e ujit ne rrjetin e distribuimit	Shpenzimi i kripës,	Shpenzimet e enrg. Elektrike
Muaji	m^3	kg	MWh
janar	10,159	10,825	1,549.31
shkurt	9,055	9,950	1,481.38
mars	10,747	13,225	1,417.72
prill	9,282	11,500	1249.007
maj	68	550	94.69
qershor	0	0	45.21
Total	**39,311.0**	**46,050.0**	**5,837.31**

CO2 ambienti


Energjia termike e realizuar në janar-qershor 2023 (199,865 MWhTER) sikur të gjenerohej në kaldajat e ngrohtores, me lëndë djegëse mazut, në ambient do të emetoheshin 75,548.96Ton CO2. Ndërsa, kur e njëjta energji prodhohet nga linjiti në TE Kosova B, përmes sistemit të koogjenerimit, lirohen 19,681.83Ton CO2.

Diferenca prej 55,867.13Ton CO2, të emetuara më pak, është impakt shumë pozitiv në mbrojtjen e ambientit. Kur të mirren parasysh edhe zvogëlimet e komponenteve tjera të dëmshme (SO2, Nox), atëherë impakti pozitiv në mbrojtje të ambientit është shumë domethënës, posaçërisht, kur dihet se ngrohtorja tanimë është në qendër të qytetit.

Ditët e shkallëve të ngrohjes dhe temperaturat mesatare mujore

Tabela 13. Grad ditore dhe temperaturat mesatare mujore gjatë periudhës raportuese.

Muaji	janar	shkurt	mars	prill	Total.
Grad ditore	468	450	360	283	1,278
Temperaturat mesatare	4.9ºC	4.15ºC	8.4ºC	9.7 ºC	8.82 ºC



Me datë 28.04.2023, në mëngjes në ora 8:30 është ndërprerë zyrtarisht sezona ngrohëse 2022/2023

BILANCI VJETOR I ENERGJISË TERMIKE

PODHIMI BRUTO DHE NETO I ENERGJISË TERMIKE, ENERGJIA E LIFERUAR DHE HUMBJET

Tabela 14. Bilanci vjetor i energjisë termike

Total bruto prodhimi Janar-Prill 2023					199,865MWh
Prodhimi bruto dhe neto i energjisë termike sipas muajve					
	Janar	Shkurt	Mars	**Prill**	**TOTAL**
Prodhimi Bruto në stabilimentet prodhuese në ngrohtore	0	48	0	0	**0**
Bruto prodhimi në stabilimenet e kogjenerimit	55,750	52,022	51,911	40,134	199,865
Total bruto prodhimi i energjisë termike (MWth)	55,750	52,070	51,911	40,134	199,865
Humbjet sasiore në rrjetin e transportit (rrjetin e kogj.)	1,115	1,040	1,038	803	3,997
Humbjet në përqindje në rrjetin e transportit	2%	2%	2%	2%	2%
Konsumi vetanak	163	141	130	103	537.57
Neto prodhimi i energjisë termike (MWH)	54,472	50,887	50.743	39,229	195,330
Energjia e liferuar					**176,157MWh**
Energjia termike e liferuar tek konsumatorët	49,079	46,671	45,415	34,992	**176,157**
Humbjet në rrjetin e shpërndarjes					
Humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes	5,393	4,216	5,328	4,237	**19,173**
Humbjet në përqindje në rrjetin e shpërndarjes	9.9%	8.3%	10.5%	10.8%	**9.8%**
TOTAL HUMBJET					
Total humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes					19,173 MWh
Total humbjet në përqindje në rrjetin e shpërndarjes					9.8%

Figura 6. Energjia e prodhuar, e liferuar dhe humbjet MWH në janar-prill 2023





Figura 7. Humbjet në rrjetin e transmisionit dhe në rrjetin e shpërndarjes gjatë periudhës janar-prill 2023



Divizioni i Makinerisë


Në vijim në mënyrë të përmbledhur i paraqesim aktivitetet e Divizionit të makinerisë gjatë periudhës raportuese janar-qershor 2023

Tabela 15. Aktivitetet e Divizionit të makinerisë gjatë periudhës raportuese janar-qershor 2023

Nr.	Përshkrimi	Data	Vërejtje
1	Drenazhimi nëpër puseta të kogjenerimit dhe mirëmbajtja e valvolave në puseta.	17-18 Maj	Është bërë drenazhim i pusetave në trasen e kogjenerimit si dhe pastrimi tyre.
2	Ndrrimi i diktunave të këmbysit 1, 2 KN-1, KN-2 në stacionin HRS.	Ka filluar me 10 Maj	Në proces
3	Kontrollimi i valvolave hyrje-dalje të Kaldajave K-1 dhe K-2 dhe kllapneve të tyre, etj.	11 Maj	Është kryer revizioni i valvolave në hyrje-dalje të Kaldajave K-1 dhe K- dhe kllapneve të tyre.
4	Kontrollimi si dhe testimi me ujë i sistemit të rezervarve: R1, R2, R3 dhe R4.	12 Maj	Janë kontrollar dhe testuar me ujë sistemi të mazutit të rezervarve R1, R2, R3 dhe R4.
5	Pastrimi i filterave të pranimit të mazutit dhe filterat e degëzimeve në rezervar.	19 Maj	Është bërë pastrimi i fileterave të mazutit dhe filterave të degëzimeve në rezervar.
6	Kontrollimi i valvolave hyrje –dalje të pompave qarkulluese dhe kllapneve.	19 Maj	Është bërë-revizionimi dhe kontrollim i valvolave në hyrje – dalje të pompave qarkulluese dhe kllapneve.
7	Patrimi i gypave të transmiterave në stacionin HRS.	22 Maj	Bashkë me divizionin e elektrikes është bërë pastrimi i gypave të transmiterave në stacionin HRS
8	Pastrimi i filterave te paisja për mbajtjen e presionit, në rrjeten e kogjenerimit	23 Maj	Po ashtu është kryer edhe pastrimi i filerave te paisja për mbajtje të presionit në rrjeten e kogjenerimit.
9	Mirëmbajtja e paisjeve në stacionin HRS.	24 Maj	Është bërë mirëmbajtja e paisjeve të degazifikimit në stacionin HRS
10	Pastrimi i gypave të transmiterave në stacionin HES.	29 Maj	Janë pastruar gypat e transmiterve në stacionin e HES-it Obiliq
11	Konzervimi kaldajave K-2 dhe kaldajave në NS	Maj	Konzervimi nuk është kryer për arësye se kaldaja K-2 në NQ është në procedur të prokurimit për rehabilitim, kurse kaldjat K-1 dhe K2 në NS nuk janë konzervuar për arësye se kemi qenë në gjendje gatishmërije për punë në furnizim me ngrohje të QKUK-së. Konzervimi do të kryhet në muajin Korrik 2023.
12	Pastrimi dhe konzervimi i kaldajes K-4 Konzervimi i kaldajave në NQ,	Maj	Kaldaj K-4 do të konzervohet në Korrik 2023.
13	Revizioni i flakërusve të kaldajave: K1 dhe K2, dhe paisjet përcjellëse.	12 Maj	
14	Revizioni i ventilatorëve të Kaldajave K-1 dhe K-2, flakërusve të Kaldajave.	6 Qershor	Është kryer me sukses revizioni i ventilatorve të kaldajave K-1 dhe K-2.
15	Revizioni i valvolave hyrje-dalje të kolektorëve (Pika I.16 e planit aksional).	7 Qershor	Edhe bërë revizioni i valvolave në hyrje – dalje të kolektorëve.
16	Revizioni i flakruesve të Kaldajave: K1 dhe K2 dhe paisjeve përcjellëse	7 Qershor	Revizioni i flakruesve të kaldajave K1 dhe K2 është kryer sipas planit aksional.
17	Revizioni i valvolave në hyrje-dalje të Kaldajave: K1 dhe K2.	8 Qershor	Revizoni i është kryer sipas planit aksional.
18	Ndrrimi i diktunave të këmbysit KN-1, në stacionin HRS.	10 Maj	Janë shtuar 40 diktuna dhe fletëza te KN-1 dhe në KN-2
19	Revizioni i flakërusit të kaldajës K-4.	12Qershor	Kjo pikë e palanit është realizuar me sukses nga ekipa e remontit.
20	Kontrollimi i valvolave dhe kllapneve para pompave riqarkulluese të Kaldajave K-1 dhe K-2.	13Qershor	Është bërë kontrolli i valvolave dhe kllapneve para pompave riqarkolluse të kaldajave K-1 dhe K-2.



21	Revizioni i pompës qarkulluese të mazutit.	13Qershor	Ju është bërë revizioni pompave qarkulluse të mazutit.
22	Kontrollimi i valvolave nga zbutsat deri te rezervari ditor (Ena ekspanduse).	14Qershor	Edhe valvolave te zbutsave deri ne rezervar ditor ju është bërë kontrolla.
23	Kontrollimi i matësve të ujit në dalje të zbutsave dhe në matësve në kethim në rezervarin ditor.	14Qershor	Kjo pikë e palanit aksional është realizuar nga ekipa e remontit në kohën e parapar.
24	Pastrimi i kanalit të vijes së mazutit nga rezervaret deri te kaldajat K-1 dhe K-2, sipas nevojes. (Pika III.8 e planit aksional).	15Qershor	Është bërë një kontroll i kanalit të vijës së mazutit deri te kaldajat K- dhe K-2.
25	Kontrollimi i tymtarit, drenazhimit si dhe riparimi i kulmit sipas nevojes. (Pika V.6 e planit aksional).	16Qershor	Edhe tymtarit dhe kulmit ju është bërë kontrolli, po ashtu edhe drenazhimi.
26	Revision i pompave për mbajtjen e presiont në rrjet të kogjenerimit. (Pika VII.5 e planit aksional).	19Qershor	Është bërë revizion pompave për mbajtje të presionit nërrjet te Kogjenerimit.
27	Kontrolli vizuel i kondenzatorve nga ana ujore e gypave KDN-1 (Pika VIII.5 e planit aksional).	22Qershor	Është bërë kontrolla e kondenzatorve.
28	Revizioni i pompës për mbushje të shpejt (Pika I.13 e planit aksional).	23Qershor	Kemi bërë revizion pompës pë mbushje te shpejt
29	Kontrollimi i valvolave të rezervaërve të naftës. (Pika V.5 e planit aksional).	26Qershor	Edhe valvolave të naftes ju është bër kontroll.
30	Kontrollimi i kllapneve jokthyese DN300 mm, dhe kontrolli i filtrave. (Pika I.12 e planit aksional).	27Qershor	Është bërë kontrolla e tyre.
31	Riparimi i dyerve dhe dritareve në objektin në hyrje anën e ventilatorit, sipas nevojës. (Pika I.8 e planit aksional).	29Qershor	Riparimi i dyerve dhe dritareve të objektit është bërë në vendin e parapar.
32	Kontrollimi si dhe testimi me ujë i sistemit të rezevuarve: R1, R2, R3 dhe R4. (Pika I.17 e planit aksional).	22Qershor	Është bërë testimi i sistemit të ftofjes së rezervuarve i cili është funksional.




Divizioni i elektrikës


Tabela 16. Aktivitetet e Divizionit të elektrikës gjatë periudhës raportuese janar-qershor 2023

Nr.	Përshkrimi	Data	Vërejtje
1	Pjesa e tensionit të mesëm (10kV); Pastrimi dhe kontrollimi i tepiheve izolues në Trafostacion Pajisjet e tensionit 10kV, me projektin e kogjenerimit janë ndërruar tërësisht, prandaj nuk ka nevojë për ndonjë intervenim. Do të bëhet vetëm kontrollimi dhe pastrimi i i tyre.	18.05.2023	Është bërë pastrimi i tepihave izulues dhe njëkohësisht është bërë pastrimi i dhomës nga gjera të panevojshme.
2	Aftësimi i ndriqimit të jashtëm në NQ. Ndërrimi i poqave dhe intervenimet e nevojshme për ndriqim.	15.06.2023	Është rregulluar furnizimi në njërën nga shtyllat ndriquese e cila kishte problem me fazë dhe njëkohësisht janë nderruar poqat elektrike në 6 shtylla në oborin e NQ.
3	Pastrimi i të gjitha PS-ve në dhomën e kontrollit dhe punët tjera në pultin komandues: Serverët në pultin komandues; PC-ja për stacionin Bregu i Diellit e vendosur në pultin komandues; PC-ja për stacionin në Obiliq e vendosur në pultin komandues; PC-ja në stacionin Bregu i Diellit; Pastrimi detal i pultit komandues; Rregullimi dhe përforcimi i përquesve në kanale; Ndërrimi i tasterëve të dëmtuar; Kompletimi me llampave sinjalizuese; Kompletimi i ndriqimit në pult dhe termokomandë;	22.05.2023	Është bërë pastrimi i serverëve në pultin komandues, PC-në për bregun e Diellit, PC-në për stacionin në Obiliq, PC-ja në Bregun e Diellit, pastrimi i pultit komandues, janë kontrolluar dhe intervenuar në kanalet e kabllove, nuk ka patur nevojë për ndërim të tasterëve, llampave apo ndriqimit në termokomandë.
4	Identifikimi i problemit për alarmin: "Possible SQL data loss" në SCADA dhe shikimi i mundësisë në rregullimin e problemit.	30.05.2023	Është bërë identifikimi i problemit për alarmin, e cila nënkupton mbushjen e databazës me të dhëna. Nuk është bër resetimi i saj për shkak se do të punohet në projektin për zgjerim nga ERGOTEM.
5	Pastrimi i filtrave për frekuentorët e elektromotorve të pompave qarkulluese të koogjenerimit 121_122P001. Pastrimi dhe shtrëngimi i kabllove.	17.05.2023	Është bërë pastrimi i të gjitha filterave në panelet komanduese për dy pompat e kogjenerimit. Njëkohësisht janë hapur klembertët dhe është shikuar nëse ka nevojë për shtrëngim të përquesve.
6	Elektromotorët e pompave qarkulluese konstante: (P=250 kW) Pastrimi i elektromotorëve; Hapja e klembertëve, kontrollimi dhe shtrëngimi i kabllove furnizuese; Kontrollimi dhe verifikimi i funksionalitetit të qarkut komandues;	29.05.2023	Është bërë pastrimi i elektromotorëve, hapja e klembertëve derisa kabllot ishin mjaftueshëm të shtrënguar dhe njëkohësisht është bërë verifikimi i funksionalitetit të komandimit.
7	Drenazhimi dhe pastrimi i të gjithë transmiterëve; Kontrollimi dhe shtrëngimi i gypave impulsiv, valvolave, blendave dhe elementeve tjera përcjellëse; Kontrollimi i kabllove nga transmiterët deri në pultin komandues;	22.05.2023	Është bërë drenazhimi i transmiterëve në HES dhe HRS dhe janë përfunduar edhe pikat 2 dhe 3 të këtij pozicioni.
8	Rregullimi i problemit me ventillin 160V005 i cili po hapet dhe mbetet në atë pozicion, mirëpo nuk po mbyllet edhe përkundër faktit që shtypja bie në 4.85Bar. Matja e sinjalit komandues 4-20mA nga PLC; Matja e sinjalit kthyes 4-20mA nga transmiteri; Testimi i pranimit të komandës brenda në ventill;		Është bërë matja e sinjaleve komanduese 4-20mA nga PLC dhe matja e sinjalit kthyes 4-20mA nga transmiteri të cilat kanë rezultu që janë në rregull, ndërsa mbetet të shikohet rreth solenoidit brenda ventillit për të identifikuar saktë problemin.
9	Identifikimi i problemit dhe sipas mundësisë rregullimi i problemit për kyçjen automatike të ventillit për mbushje të rezervuarit të ujit. Testimi i nivel matësit në rezervuar; Testimi/programimi i kontrollerit; Testimi i ventillit komandues; Potencialisht do të punohet në tender.		Meqenëse do të punohet për një sistem të ri nga Ergotem (sipas tenderit), nuk kemi punuar në këtë pozicion.
10	Identifikimi i problemit dhe sipas mundësisë rregullimi i problemit të pamundësisë për ngritje/zbritje të rymave nga dhoma e kontrollit, për pompat variabile 62P1 de 62P2. Matja e sinjalit analog nga dhoma e kontrollit në frekuentor;		Sinjali në fjalë do të futet në SCADA sipas tenderit, prandaj nuk kemi punuar në këtë pozicion.





11	Ngritja e sigurisë në furnizimin me enerjgi elektrike për sistemin REFLEX.		Për të përfunduar këtë pozicion, jemi në pritje të kontaktorit për të cilën është bërë kërkesa.
12	Pjesa e tensionit të ulët TU (0.4kV); Kontrollimi, pastrimi dhe shtrengimi i zbarrave të TU; Verifikimi i funksionalitetit të ndërprerësve DU-2000 dhe pastrimi i kontakteve të tyre; Kontrollimi i të gjitha kabllove që gravitojnë në zbarrat e TU dhe shtrëngimi i tyre;		Për shkak se nuk kemi patur hapsirë për ndalje të tensionit, kjo punë mbetet të bëhet në javët në vijim.
13	Sistemi për kompenzim të energjisë reaktive Pastrimi i ormaneve dhe baterive 25kVAr; Kontrollimi dhe pastrimi i kontaktorëve; Kontrollimi i bazamenteve të siguresave dhe kompletimi i tyre me siguresa;	15.06.2023	Është bërë pastrimi i ormonëve dhe baterive 25kVAr edhe pse janë të vjetra më shumë se 4 dekada, kontrollimi dhe pastrimi i kontaktorëve dhe kompletimi me siguresa të nevojshme.
14	Ormani shpërndarës RTM-1 dhe i pompave furnizuese: Kontrollimi dhe pastrimi i ormanëve;	30.06.2023	Janë ndëruar dy siguresa automatike 25A dhe është rregulluar një kabëll komandues për pompat e cila bartet nga RTM-1 deri në dhomën e kontrollit. Përveç saj, është bërë pastrimi i ormonit.
15	Elektromotorët e pompave qarkulluese variabile (P=315kW) Pastrimi i elektromotorëve; Hapja e klembertëve, kontrollimi dhe shtrëngimi i kabllove furnizuese; Kontrollimi dhe verifikimi i funksionalitetit të qarkut komandues	30.05.2023	Pozicion i përfunduar, i cili është paraparë për muajin Qershor.
16	Elektromotorët e pompave riqarkulluese P=90kW Pastrimi i elektromotorëve;Hapja e klembertëve, kontrollimi dhe shtrengimi i kabllove fuirnizuese; Kontrollimi dhe verifikimi i funksionalitetit të qarkut komandues; Lubrifikimi i kushinetave me yndyrë nëse është e nevojshme;	05.06.2023	Pastrimi i kontakteve në panelat e pompave riqarkulluese, hapja e klembertëve, kontrollimi dhe shtrëngimi i përquesve në rastet e nevojshme dhe pastrimi i elektromotorëve.
17	Elektromotorët e ventilatorëve të K1 dhe K2 P=250kW Pastrimi i elektromotorëve; Hapja e klembertëve, kontrollimi dhe shtrengimi i kabllove furnizuese; Kontrollimi dhe verifikimi i funksionalitetit të qarkut komandues; Lubrifikimi i kushinetave me yndyrë nga makineria;	07.06.2023	Është bërë hapja e klembertës në elektromotorin e ventillatorit K1 e cila kishte ujë të depërtuar në brendi të saj. Prandaj është larguar ajo sasi e ujit me një pompë mekanike dhe është mbyllur mirë kapaku tek elektromotori i ventillatorit K1 nga cili ka depërtuar uji brenda. Njëjt është vepruar edhe në ventillatorin K2, derisa nga makineria është bërë lubrifikimi i kushinetave në të dyja ventilatorët.
18	Elektromotorët e pompave për mbajtje të shtypjes në sistemin e distribuimit. Kontrollimi dhe pastrimi i motorëve; Është në planifikim instalimi i rregullatorëve frekuentor për elektromotorët e këtyre dy pompave.		Meqenëse do të bëhet punë nga Ergotem-Brunata sipas projektit të planifikuar, nuk kemi punuar në këtë pozicion.
19	Pajisjet për lëshim në punë, rregullim të shpejtësisë dhe mbrojtje të elektromotorëve: Simovert VC/DC Drive; Sikostart Siemens; ACS800, ABB Pastrimi dhe kontrollimi detal i ormanave komandues; Kontrollimi i kontaktorëve dhe ndërprerësve energjetik; Kontrollimi i kabllove dhe shtrëngimi i tyre; Kontrollimi dhe pastrimi i ventilatorëve dhe ndërrimi eventual i tyre; Verifikimi dhe aftësimi i qarkut komandues.	16.06.2023	Janë kontrolluar Simovert VC/DC Drive, Sikostart Siemens dhe ACS800, njëkohësisht është bërë edhe pastrimi i ormonëve komandues.
20	Pajisjet për lëshim në punë në mënyrë direkte të pompave 31P1 & 41P1:Pastrimi i kontakteve të KS-160A; Shtrëngimi i kabllove; Kontrollimi i qarkut mbrojtës dhe verifikimi i funksionalitetit të tij	09.06.2023	Është bërë kontrollimi i qarkut mbrojtës, funksionaliteti i tij dhe shtrëngimi i kabllove për pompat 31P1 dhe 41P1.
21	Izolimi i nxemsave tek rezervari ditor.	07.06.2023	Janë izouluar nxemsat tek rezervuari ditor.
22	Ormanët komandues për K-1 dhe K-2 (Petrokraft dhe Saacke) Pastrimi i ormanëve; Kompletimi i dritave sinjalizuese; Kontrollimi i kontaktorëve për flakërues dhe ventilator të ajrit primar; Kaldajat nuk janë në punë prej disa vitesh, prandaj duhet të verifikohet gjendja e pajisjeve elektrike dhe të mbyllen ormanat komandues.	19.06.2023	Është punuar në pastrimin e ormonëve, kompletimin e dritave sinjalizuese dhe janë kontrolluar kontaktorët, rrjedhimisht funksionaliteti i komandimit për sistemin e kalldajës K-1 dhe K2.



23	Nxemsat elektrik në gypat e mazutit të K1 & K2 Të kontrollohen të gjithë nxemsat; Nxemsat e dëmtuar të zëvendësohen; Të bëhet izolimi i gypave, aty ku është e nevojshme;	30.06.2023	Kontrollimi i nxemsave elektrik në gypat e mazutit të K1 dhe K2 duke mos patur nevojë për ndonjë ndërrim të nxemsave.
24	Nxemësi elektrik i mazutit P=150kW Kontrollimi i nxemsave, pastrimi dhe shtrëngimi i klembertit; Diskutimi për bërjen eventuale të një ajrosjeje në pozicionin ku janë të vendosur nxemsat; Pastrimi dhe kontrollimi i ormanit komandues; Kontrollimi i ventilatoirëve për ftofje; Pastrimi i kontakteve të kontaktorit kryesor;	23.06.2023	Janë kontrolluar nxemsat elektrik të mazutit P=150kW, është bërë shtrëngimi i klembertit, është pastruar ormoni komandues, janë kontrolluar ventilatorët dhe pastruar kontaktet e kontaktorit të cilat janë në rregull dhe tani edhe i kemi kyçur me qëllim të ngrohjes së mazutit për qarkullim dhe zbrazje së mazutit nga rezervuari 2 dhe 3 në rezervuarin 1 dhe 4. Pas diskutimit, nuk e kemi parë të arsyeshme pozicionin 2 të kësaj pike aksionale.
25	Remonti i pajisjeve elektrike në stacionin e mazutit Kontrolimi dhe pastrimi i ormanit elektrik; Kontrollimi, pastrimi dhe ndërrimi eventual i kontaktorëve të pompave për qarkullim dhe zbrazje të mazutit. Kompletimi i ndriqimit në stacion; Kontrollimi dhe funksionalizimi i të gjithë nxemsave elektrik;	27.06.2023	Për shkak të kërkesës për zbrazje të mazutit nga rezervuari 2 &3 në rezervuarin 1&4, kemi intervenuar në bazën e siguresës dhe kontaktin e kontaktorit për startimin e pompës 2 të qarkullimit. Ndërsa meqenëse do të bëhet zhvendosja e atij stacioni për shkak të ndërtimit të objektit të administratës, nuk planifikojmë më shumë punë në atë stacion. Pozicion i planifikuar për Gusht.
26	Upload i programeve nga PLC-të, të cilat janë në operim brenda në NQ, HES dhe stacionin Bregu i Diellit: PLC Siemens – CPU 414-5H në NQ; PLC Siemens – CPU 414-5H në HES; PLC Siemens – CPU 315 – 2DP në stacionin Bregu i Diellit; PLC Siemens – CPU 314 – Sistemi për mbajtje të presionit; Vërejtje: nëse arrijmë t'a blejmë MPI adapter-in për kyçjen në PLC-të në fjalë.	16.06.2023	Pasi që kemi siguruar password-in nga Felix, janë siguruar programet e PLC-ve për NQ dhe HES duke bërë njëkohësisht edhe testimin në modin "Online" me verzionin ekzistues që operon në PLC dhe rezulton të jenë në rregull. Kjo ndërlidhet me pikën 1 dhe 2 të pozicionit II.27, të paraparë për muajin Gusht.
	Punet jashtë planit		
28	Deri më datën 04.05.2023 ishtë në punë kalldaja 1 tek ngrohtorja e spitalit, nga ora 06:00 - 09:00 të mëngjesit dhe 18:00 – 21:00 pasdite. Ndërsa më datën 05.05.2023 është kyçur në punë në ora 06:00 mirëpo është ndalur në ora 06:15 për shkak të mungesës së lëndës djegëse dhe nuk është kyçur më. Ndërsa teknikët e elektrikës kanë qenë në ndërrim deri më datën 09.05.2023.		
29	Shtrirja e kabllos 5x10mm2 nga hyrja e AS-it në hyrje të siguresës 3 polare të vendosur në HES_LV_001HES_LV_001 (++N01 - Supply) dhe njëkohësisht nga dalja e siguresës 3 polare deri në hyrje të klemeve të vendosura në +HES_AS_001, me qëllim të realizimit të furnizimit të PLC-së me energji elektrike jashtë ndërprerësit AS.	16.05.2023	Është bërë shtrirja e kabllos 5x10mm2 nga hyrja e AS-it në hyrje të siguresës 3 polare të vendosur në HES_LV_001HES_LV_001 (++N01-Supply) dhe njëkohësisht nga dalja e siguresës 3 polare deri në hyrje të klemeve të vendosura në +HES_AS_001.
30	Takim me përfaqësuesit e inspektoratit të komunës së Obiliqit dhe punëkryesin e kontraktuar (Rukolli) nga TrainKos.	05.05.2023	Në Obiliq është realizuar takimi me përfaqësuesit e inspektoratit të Komunës dhe punëkryesin e kontraktuar nga TrainKos për trasenë e hekurudhës, në lidhje me rezikun eventual për mbulimin e gypave të Termokosit nga ana e tyre. Fatmirësisht nuk është shkaktuar ndonjë problem nga ana e kompanisë Rukolli, të cilës i janë dhënë koordinatat e trasesë së gypave nga ana jonë dhe në prezencën e inspektoratit jemi dakorduar për zonën e cila nuk duhet të preket (zonë e rrethuar me shirit të kuq nga ana e Termokosit).
31	Takim me përfaqësuesit nga ERGOTEM të cilat janë përgjegjës për kryerjen e punëve në projektet, përfshirë frekuentorin për pompën 3 të kogjenerimit, frekuentorin për pompën 5 të distribuimit, zëvendësimin e softstarterëve me frekuentorë për pompat 62P3 dhe 62P4 të distribuimit dhe informacione rreth statusit me softuer (për PLC-Step 7 dhe SCADA-WinCC) në të cilat duhet të ndërhyet. Qëllimi i takimit kishte të bëj për marjen e informacionevë rreth lokacionit ku do të vendoset sistemi i ri.	08.05.2023	Siq i kam informuar edhe më herët, Ergotem ka vërtetuar se softuer-i është i mbrojtur me password dhe për këtë duhet të kontaktohet kompania që ka bërë softerin me qëllim që të marrim softuer-in pa lock-a dhe me të gjitha komentet brenda saj për të cilën është diskutuar edhe në takimin mujor të datës 10.05.2023. Poashtu jemi përgjigjur edhe në informacionet e kërkuara për sistemin e kogjenerimit nga Ergotem.
32	Largimi i kabllos nga shtylla e dëmtuar në oborin e Termokosit.	18.05.2023	Është larguar kablloja nga një shtyllë e dëmtuar e ndriqimit. Shtylla në

			fjalë nuk mund të ripërdoret, prandaj instalimi i izoluar mbetet në rast se planifikohet për vendosje të ndonjë shtylle të re në të ardhmën.
33	Largimi i kabllos së furnizimit 3x2.5mm2 e cila kishte furnizuar portën e sigurimit, e cila portë është larguar.	18.05.2023	Largimi i kabllos së furnizimit 3x2.5mm2 e cila kishte furnizuar me energji elektrike kabinën e sigurimit, e cila është hequr nga pozicioni ku ishte.
34	Ndërrimi i dy ndërprersave 3 polar (për pompën 1 dhe asaj rezervë të kondenzatit) të cilat janë dëmtuar më datën 19.04.2023 dhe atëherë është bërë vetëm zgjidhje e përkohshme deri në ardhjen e ndërprersëve të porositur.	08.06.2023	Kemi shfrytëzuar kabllon 5x10mm2 të shtirë më herët, nga hyrja e AS-it deri në hyrje të klemeve të vendosura në +HES_AS_001, duke furnizuar PLC-në me energji elektrike jashtë ndërprerësit AS dhe është bërë ndërimi i dy ndërprersave të dëmtuar 3 polar (për pompën 1 dhe asaj rezervë të kondenzatit).
35	Largimi i panelit të operimit lokal për ventillatorin K1 i cili nuk është në shfrytëzim për kohë të gjatë, duke i izoluar kabllot në atë zonë.	12.06.2023	Është larguar paneli i operimit lokal për ventillatorin K1 i cili nuk është në shfrytëzim për kohë të gjatë, duke i izoluar kabllot dhe pastruar atë zonë. Rreth asaj zone do të vendoset sistemi i ri për mbajtje të presionit në distribuim.
36	Intervenim në ndriqimin tek zyrja e Arhivës.	15.06.2023	Është rregulluar ndriqimi tek zyrja e Arhivës.
37	Planifikimi për shpenzimin me energji elektrike dhe investimeve brenda Divizionit të Elektrikës, për sezonin 2023-2024.	15.06.2023	Është punuar në planifikimin për investime brenda Divizionit të Elektrikës.
38	Angazhim për Ergotem, në lidhje me punën që do të bëhet në SCADA dhe PLC.	26.06.2023	Angazhim në lidhje me kërkesat nga Brunata&Ergotem në lidhje me punën që do të bëhet në SCADA dhe PLC me çrast i kemi siguruar password-in nga Felix për çasje online ne PLC. Pastaj kemi marr softuerin nga George dhe i kemi bërë compare atij verzioni me verzionin aktual në PLC e cila nuk ishte identike. Ndërsa më vonë kemi mundësuar qasjen remotely në PLC për programerin Schutze (kemi intervenuar në furnizim të switch-it) me qëllim të kompletimit të programit me simbole dhe komente të kërkuar nga Brunata&Ergotem dhe është plotësuar kërkesa nga konsorciumi në lidhje me specifikat e kërkuara për programin ekzistues.
39	Kyqja e nxemsave tek mazuti me qëllim të zbrazjes dhe bartjes së mazutit nga rezervuari 2&3 në rezervuarin 1&4.	20.06.2023	Është bërë kyqja e nxemsave tek mazuti me qëllim të zbrazjes dhe bartjes së mazutit nga rezervuari 2&3 dhe bartja në rezervuarin 1&4, me qëllim të lirimit të lokacionit për shkak të ndërtimit të ndërtesës së administratës.
40	Largimi i instrumenteve/pajisjeve elektrike dhe automatike nga depoja poshtë e cila do të rënohet.	21.06.2023	Janë larguar instrumente/pajisje elektrike dhe automatike nga depoja poshtë e cila do të rënohet.
41	Ndërrimi i poqave dhe gypave ndriques në hollin e prodhimit dhe në koridorin tek ndërtesa e prodhimit.	22.06.2023	Janë ndëruar 6 poqa elektrik në hollin e prodhimit dhe 3 gypa ndriques në koridorin e zyreve tek ndërtesa e prodhimit.
42	Sensori dhe furnizimi për reklamën "Termokos" brenda ne obor.	29.06.2023	Është bërë lidhja e sensorit dhe furnizimi me energji elektrike për reklamën në oborin e Termokos-it.



Divizioni i PKU-së

Gjate periudhës raportuese janar-qershor 2023 nga Divizioni i PKU-se janë realizuar këto aktivitete:

- Është përgatitur uji në sistemin e ngrohjes.
- Është realizuar pastrimi kimik i gjithsej 6 këmbyesve të nxehtësisë në rajoni Bregu i Diellit dhe 1 këmbyes në rajonin Dardania.
- Gjatë muajit Maj është realizuar pastrimi kimik me tretësirë të acidit klorhidrik i dy këmbyeseve të nxehtësisë, këmbyesit Nr1 dhe Nr.2 Sondex, sistemi i koogjenerimit.
- Është realizuar pastrimi me tretësirë bazike të NaOH dhe konservimi me vaj SAE30 i kaldajave K1 dhe K2, ngrohtorja te spitali dhe kaldaja K4 në ngrohtoren në Termokos si dhe është rekomanduar mbyllja e tyre. Është realizuar kontrollimi dhe pastrimi i enës për përgatitjen e tretësirës së kripës së NaCl , sistemi i koogjenerimit. Është pastruar puseta sedimentuese .
- Nga data 23.05.2023, me kërkesë të menagjmentit, stafi i PKU-së është angazhuar në zhvendosjen e substancave kimike nga depoja ekzistuese për në hapsirë tjetër (zgjidhje e përkohshme) , shkaku se depoja ekzistuese planifikohet të rrënohet. Ky angazhim ishte jasht planit aksional. Zhvendosja e substancave kimike ka përfunduar më 31.05.2023. Pastaj është bërë selektimi dhe evidentimi i gjithë matrialit.

Pastrimi kimik i këmbyesve të gjate periudhes raportuese Janar-Qershor 2023


Tabela 17. Pastrimi kimik i këmbyesve të gjate periudhes raportuese Janar-Qershor 2023

Muaji	Stacioni qëndror	Bregu i Diellit	Dardania
Gjithsej	2	6	1

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2023 në Divizioni e PKU-së janë realizuar pothuaj të gjitha punët e parapara me Planin Aksional 2023.

Punët dhe aktivitetet kryesore të cilat janë kryer në gjashtemujorin e parë 2023, mund ti permbledhim, si në vijim:

- Furnizim me avull për ngrohje nga Blloku B2;
- Në muajin shkurt 2023, është punuar 3h pune më kaldajën K-2, për shkak të marrjes së rezultatev të analizave të gazrave dhe të pluhurit të cilat janë kërkuar nga MMPHI për Leje të integruar Mjedisore;
- Kontroll në puseta të kogjenerimit në menyrë të kohë pas kohshme;
- Mirëmbajtje të stabilimenteve termoenergjetike;
- Pastrimi i filterave në NQ dhe në stacion HES, dhe në stacionin Bregu I Diellit;
- Matjet e vazhdushme javore e temperaturave në pompa me paisje speciale për matje të të gjitha pompave në departament;
- Drenazhim në stacionet: HES dhe HRS;
- Sigurimi i kabllit optik në llaguna P04/P05;
- Lubrifikim i pompave të koondenzatit në stacionin HES;
- Sanimi i rrjedhjes së paraqitur në gypin e ngrohjes së mazutit afër rezervuarve të mazutit.
- Pastrimi dhe ndrrimi i diktunave në këmbyesit KN-1 dhe KN-2 në stacionin HRS;
- Pastrimi kimik dhe konzervimi i kaldajes K-2, K-4 në NQ dhe pastrimi dhe konzerviimi I kaldajave K2 në Ngrohtoren e Spitalit;
- Bartja e lëndës djegëse nga rezervuari R2 në rezervuarin R4;
- Pastrimi i filterave;
- Testimi i sistemit të freskimit të rezervuarve të Mazutit
- Nga muaji Maj ka filluar realizimi i Planit Aksional 2023, për muajt Maj dhe Qershor te cilat janë paraqitur ne kete raport.




Më datë 20.02.2023, në intervalin kohor nga ora 11:00-16:00, për shkak të pamundësisë së furnizimit me avull për ngrohje, furnizimi me ngrohje për konsumatorë ka vazhduar për këtë interval por me cilësi më të dobët, vetëm kemi operu me pompa dhe qarkullimi nuk është ndalur;
Në muajin Janar janë bërë matjet e emitimit të gazrave nga instituti "Inkos", dhe rezultatet e fituara nga matjet janë brenda Udhëzimit Administrativ 07/2021.
Pas datës zyrtare të përfundimit të sezonës ngrohëse 2022/23, me kërkesë të QKUK-së është punuar me ngrohtoren e spitalit në periudhen kohore 29.04-03.05.2023. Regjimi i punës së kadajave është përshtatur kërkesa e QKUK-së për këtë periudhë kohore. Është punuar me kaldajen K1 gjithësej 22.5h pune dhe janë shpenzuar 5394 litra naftë, ku nafta ka qenë e QKUK-së një sasi e Termokosit. Puna e kaldajve është paraqitur në raportet ditorë të kaldajave të cilën orgjinalin e kanë marrë zyrtarët e QKUK-së dhe një kopje për Termokos.

Në janar-qershor 2023 janë instaluar 866.5 metër gyp me paraizolim dhe 454 metër gyp çeliku.

Instalimi i gypave metër gjatësi në janar-qershor 2023:

1,320.5m'

Figura 8. Instalimi i gypave të paraizoluar dhe të çelikt





Aktivitetet e Departamentit të Distribuimit

Gjatë periudhes janar-qershor , Departamenti i Distribuimit ka pasur këto aktivitete:

Intervenimet në sistemin primar të ngrohjes;

- Instalimi i gypave,
- Instalimi i kthesave,
- Instalimi i valvolave,
- Instalimi i filtrave
- Instalimi i pompave,
- Instalimi i këmbyesëve
- Pastrimi i këmbyesëve

Intervenimet në sistemin sekondar të ngrohjes;

Instalimi i matësve të energjisë

Kyçjet e reja;

Puna me palë të treta;

Raportimi mbi humbjet e ujit dhe energjisë termike, dhe

Aktivitete tjera.

Instalimi i gypave

Gjatë periudhës raportuese janë instaluar gjithsej 1,320.5 metër gyp prej të cilave 866.5 metër gyp i paraizoluar si dhe 454 metër gyp çeliku.

Tabela 18. Pasqyra përmbledhëse e aktiviteteve të Departamentit të Distribuimit gjatë periudhës janar-qershor 2023

nr	Aktiviteti	totali	Njësia
1	Intervenimet në rrjetin primar të ngrohjes		intervenime
2.	Intervenimet në rrjetin sekondar të ngrohjes	51	intervenime
3.	Instalimi i gypave të paraizoluar & të çelikut	1,320.5	m'
4.	Instalimi i kthesave paraizoluar & të çelikut	151	copë
5.	Instalimi i këmbyesëve të nxchtësisë	6	copë
6.	Instalimi i valvolave të ngrohjes	87	copë
7.	Instalimi i pompave qarkulluese	15	copë
8.	Instalimi i filtrave	8	copë
9	Instalimi i matësve të energjisë	5	copë

Tabela 19. Instalimi i gypave janar-qershor 2023

Nr.	Dim.i gypit	Realiz.	Vërejtje
1	DN 15	12	Gyp çeliku
2	DN 20	18	Gyp çeliku
3	DN 25	30	Gyp çeliku
4	DN 32	57	48m gyp me paraizolim,9m gyp çeliku
5	DN 40	162	120m gyp me paraizolim, 42m gyp çeliku
6	DN 50	288	240m gyp çeliku, 48m gyp me paraizolim
7	DN 65	456	376 m gyp me paraizolim, 80 m gyp çeliku
8	DN 80	210	193 m gyp me paraizolim, 17 m gyp çeliku
9	DN 100	6	Gyp çeliku
10	DN 125	6	Gyp me paraizolim
11	DN 150	69	Gyp me paraizolim
12	DN 200	1	Gyp me paraizolim
13	DN 250	5.5	Gyp me paraizolim
	TOTAL	1,320.5	


Instalimi i kthesave

Në peridhën raportuese janar-qershor 2023 janë instaluar gjithsej 151 kthesa prej të cilave 72 kthesa të çelikut dhe 79 kthesa me paraizolim.

Tabela 20. Instalimi i kthesave

Nr.	Dim.i gypit	Realizimi	Vërejtje
1	DN 25	12	Kthesë çeliku
2	DN 32	48	Kthesa me paraizolim
3	DN 40	12	Kthese çeliku
4	DN 50	14	prej te cilave 2 kthesa me paraizolim
5	DN 65	31	prej te cilave 10 kthesa me paraizolim
6	DN 80	23	prej te cilave 11 kthesa me paraizolim
7	DN125	1	Kthese çeliku
8	DN150	9	prej te cilave 1 kthese çeliku
9	DN 250	1	Kthese çeliku
	TOTAL	**151**	

Figura 9. Paraqitja grafike e instalimit të kthesave, valvolave, pompave, filtrave, këmbyesëve dhe matësve të energjisë





Instalimi i pompave

Janë instaluar gjithsej 15 pompa në nënstacione prej te cilave 5 pompa janë te përdorura.

Tabela 21. Instalimi i pompave

Nr.	Dim. pomp	Realizimi	Vërejtje
1	DN 50	4	Dy pompa te perdorura
2	DN 65	4	Nënstacion
3	DN 80	6	Nje pompe në TNS-Kryesor , Dy pompa te perdorura në nenstacione
4	DN 100	1	Pompe e vjeter
	TOTAL	**15**	Copë

Instalimi i valvolave

Janë instaluar gjithsej 87 valvola të dimensionit te ndryshme DN 32- DN 500.

Tabela 22. Instalimi i valvolave

Nr.	Dim.i valv.	Realizimi	Verejtje
1	DN 32	6	Pusete - P. primare
2	DN 40	10	Nënstacion, pusete dhe P. primare
3	DN 50	11	Nënstacion, pusete dhe P. primare
4	DN 65	21	Nënstacion, pusete dhe P. primare
5	DN 80	23	Nënstacion, pusete dhe P. primare
6	DN 100	6	Nënstacion, pusete dhe P. primare
7	DN 125	6	Nënstacion, pusete dhe P. primare
8	DN 150	2	Pusete - P. primare
9	DN 500	2	Pusete - P. primare
	TOTAL	**87**	Copë

Instalimi i filtrave

Gjatë periudhës janar – qershor 2023, janë instalu gjithsejt 8 filtra dhe janë pastruar 171 filtra të dimensioneve të ndryshme.

Tabela 23. Instalimi i filtrave

Nr.	Dimensioni i gypit	Realizimi	Vërejtje
1	DN 50	3	Instalim
2	DN 65	5	Instalim
	TOTAL	8	

Këmbyesit e nxehtësisë

Në janar-qershor 2023 janë instaluar gjithësejt 6 këmbyes të nxehtësisë

Tabela 24. Instalimi i këmbyesëve të nxehtësisë

Nr.	Lloji dhe fuqia	Realizimi	Vërejtje
1	400kW	3	
2	200kW	1	
3	200kW	1	
4	1000kW	1	I perdorur
	TOTAL	**6**	

Pastrimi i këmbyesve të nxehtësisë

Është bërë pastrimi me kemikate i 8 këmbyesve të nxehtësisë.

Tabela 25. Pastrimi i këmbyesëve të nxehtësisë

Nr.	Lloji dhe fuqia	Realizimi	Vërejtje
1	U – 1B	1	Pastrim me kemikate
2	Klinika e kirurgjisë	1	Pastrim me kemikate
3	Rruga 2 Ilam 10	1	Pastrim me kemikate
4	Nënkalimi	1	Pastrim me kemikate
5	Rruga 2 Ilam 2	1	Pastrim me kemikate
6	TNS- Blloku	2	Pastrim me kemikate
7	Nënkalimi	1	Pastrim me kemikate
	TOTAL	**8**	

Matësit e nxehtësisë

Gjatë periudhës raportuese , janë instaluar gjithsejt 5 matës të nxehtësisë.

Tabela 26. Matësit e energjisë

Nr.	Rajoni	Adresa	Lloji	Realiz.	Data
1	DAR.	Objekti i Tregtisë		3	1.2023
2	DAR.	Polica e Kosove		1	1.2023
3	DAR.	FFK		1	1.2023
	TOTAL			5	

Kyçjet e reja

Tabela 27. Kyçjet e reja

Nr.	Adresa	Dt. e kryerjes	Vërejtje
1	Rr.B 3/1 Hy.C1 nr.13	14.02.2023	Rrjeti Sekondar
2	FFK 200kW	Shkurt 2023	1 objekt
3	Polica e Kosove, 200kW	Shkurt 2023	1 objekt
4	Objekti i Tregtisë, 3x400kW	Mars 2023	3 objekte
5	Rr Qamil Hoxha 29 Fadil Sadik	Maj 2023	P.Primare

Në janar-qershor 2023 energjia termike e liferuar është

176,157 MWht

Rritje e liferimit të energjisë termike krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, shprehur në përqindje:

11%


Energjia e liferuar


Energjia e liferuar tek konsumatorët në gjashtëmujorin e parë 2023 është **176,157 MWh**. Krahasuar me periudhën e njëjtë të dy vitet paraprake, energjia termike në janar-qershor 2023 është më e madhe për 10.8% krahasuar me janar-qershor 2022 dhe për 8.4% më e madhe krahasuar me janar-qershor 2021.

Humbjet e energjisë termike në rrjetin e shpërndarjes


Ndërsa, humbjet e energjisë termike në rrjetin e shpërndarjes në janar-qershor 2023, janë 19,174MWh ose shprehur në përqindje 9.8%. Krahasuar me periudhën e njëjtë të dy viteve paraprake, humbjet e energjisë në rrjetin e shpërndarjes, ne janar- qershor 2022 kanë qenë 10.6% dhe 10% në janar – qershor 2021 .

Figura 10. Humbjet e energjisë termike në rrjetin e shpërndarjes në janar-qershor 2023





© Statcioni HRS, Prishtinë



© Statcioni HEC, Obiliq

Humbjet e energjisë në masë të madhe janë pasojë e humbjeve të ujit. Meqenëse, realisht vlerësimi i humbjeve të energjisë deri sa nuk kemi matje në të gjitha nënstacionet është i përcjellur me pasaktësi të konsiderueshme. Me porojektin e kfW (pakoja T-1) është e planifikuar të instalohen nënstacione të reja dhe matës të energjisë në nivel të nënstacioneve për të gjitha objektet. Ky aktivitet do të mbështetet edhe nga projekti i MCC, me matësa në të gjitha nënstacionet. Me matje të saktë të energjisë në nënstacione (energjia e cila i distribuohet konsumatorëve) do të vlerësohen saktësisht humbjet dhe do të intervenohet për:


- Identifikimin dhe eliminimin e humbjeve të energjisë të shkaktuara nga humbjet e ujit;
- Zvoglimin e humbjeve për shkak të izolimeve të dobëta të gypave, sidomos në hapësirat e brendshme të objekteve;

Vlera e faturuar e energjisë termike në janar-qershor 2023 është, 1,100,524 euro më shumë se në janar-qershor 2022.

Rritja e faturimit krahasuar me gjashtemujorin e pare te vitit paraprak, shprehur në përqindje

22%

Figura 11. Faturimi në janar-qershor 2023, krahasimi me janar-qershor 2022



Aktivitetet e Departamentit të Furnizimit gjatë periudhes janar-qershor 2023

Në bazë të planit për ngritjen e arkëtimit përfshirë edhe borxhet është përgatitur plani i aktiviteteve operacionale për arkëtim të borxheve të vjetra. Është bërë faturimi real për muajt janar-qershor 2023 mbi bazë të cilësisë së ngrohjes së ofruar.

Tabela 28. Faturimi në janar-qershor 2023, krahasimi me janar-qershor 2022:

Periudha	Janar-Qershor 2022	Janar- Qershor 2023	Eval. €	Eval. %
Total faturimi	**5,004,543 €**	**6,105,067 €**	**1,100,524 €**	**21.99%**

Faturimi në gjashtemujorin e pare te vitit 2023 krahasuar me faturimin ne gjashtemujorin e pare te vitit paraprak 2022, ka qenë 22% më i lartë, shprehur në vlerë monetare 1,100,524€.


Ndërsa, të hyrat e përgjithshme nga arkëtimi i mjeteve në periudhën janar-qershor 2023 janë si vijon:

Tabela 29. Inkasimi në janar-qershor 2023, krahasimi me janar-qershor 2022:

Periudha	Janar-Qershor 2022	Janar- Qershor 2023	Eval. €	Eval. %
Total inkasimi	**4,976,161 €**	**5,953,319 €**	**977,159 €**	**19.64%**

Në vazhdim në mënyrë grafike paraqesim të dhënat e inkasimit për periudhën raportuese janar-qershor 2023 si dhe krahasimin me janar-qershor 2022.

Figura 12. inkasimi në janar-qershor 2023, krahasimi me janar-qershor 2022:



Të hyrat nga arkëtimi i mjeteve për periudhën janar-qershor 2023 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kanë qenë **20%** më të mëdha, shprehur në vlerë monetare **977,159€.**


Krahasimi i inkasimit në faturim për janar-qershor 2023


Të hyrat e inkasuara nga faturimi për periudhën janar-qershor 2023 janë si vijon:

Tabela 30. Shkalla e inkasimit në janar-qershor 2023

	Faturimi	Inkasimi	Eval. €	Eval. %
Amvisëri	3,367,929 €	1,698,200 €	1,669,730 €	50.42%
Afarist	2,737,138 €	2,108,860 €	628,278 €	77.05%
Total	**6,105,067 €**	**3,807,059 €**	**2,298,008 €**	**62.36%**

Figura 13. Shkalla e inkasimit në janar-qershor 2023





Krahasuar me periudhen janar-qershor te vitit paraprak 2022, në fund të periudhës janar-qershor 2023, kemi rritje të numrit të konsumatorëve 4,776 konsumatorë më shumë dhe kemi rritje të sipërfaqes ngrohëse për 333,778 m²

Rritje e sipërfaqes ngrohëse prej

23%

Numri aktual i konsumatorëve

Numri i përgjithshëm i konsumatorëve në fund te periudhës raportuese është 20,567 konsumatorë. Ndërsa, në fund të gjashtemujorit te pare 2022, numri i përgjithshëm i konsumatorëve ishte 15,791. Pra kemi rritje te numrit të konsumatoreve prej 30.2%.

Raporti i ankesave dhe kërkesave gjatë periudhës raportuese janar-qershor 2023

Në vijim në mënyrë të përmbledhur në formë tabelare paraqesim raportin mbi ankesat dhe kërkesat gjatë janar-qershor 2023.

Tabela 31. Raporti mbi ankesat dhe kërkesat gjatë periudhës raportuese janat-qershor 2023

muaji	Ankesa të pranuara	Përgjigjet në ankesa	Kërkesa të pranuara	Përgjigjet në kërkesa
Janar	128	237	148	207
Shkurt	175	117	16	84
Mars	139	185	102	234
Prill	80	49	57	67
Maj	75	54	79	39
Qershor	15	59	52	58
Total	612	701	454	689

Sqarim: Janë përfshirë përgjigjet edhe për ankesa dhe kërkesa të bartura nga viti paraprak.

Periudha janar-qershor 2023, shënon një efikasitet të lartë të kthimit të përgjigjeve ndaj ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve. Ky është një tregues pozitiv se shërbimet për konsumatorë nga ndërmarrja gjatë periudhes raportuese kanë qenë shumë cilësore.

Kontratat për furnizim me ngrohje

Në periudhen raportuese janer – qershor 2023, janë nënshkruar gjithësej 2,179 kontrata për furnizim me ngrohje me konsumatorë. Prej të cilave 1,854 kontrata nga sektori i amvisërisë dhe 325 nga sektori afarist.

Sipërfaqja ngrohëse

Në fund te periudhes raportuese 2023, sipërfaqja ngrohëse është 1,786,835 m². Në gjashtemujorin e pare te vitit 2022, sipërfaqja ngrohëse ishte 1,453,056m².

Figura 14. Sipërfaqja ngrohëse në TM2/2023, krahasimi me TM2/2022



Krahasuar me vitin paraprak, sipërfaqja e faturuar në janar qershor 2023, është rritur për 333,779 m², respektivisht **23%.**

Kyçjet e reja

Në periudhën raporuese janar-qershor 2023, në sistemin e ngrohjes qendrore Termokos, janë kyçur gjithësej 3,383 konsumator të rinjë me sipërfaqe prej 250,770.68 m².

Tabela 32. Konsumatorë të rinj – Kyçje të reja në janar-qershor 2023

Sektori	Numri i konsumatorëve	Sipërfaqja m²
Amvisëri	3,030	205,119.60 m²
Afarist/institucional	353	44,651.08 m²
Total	**3,383**	**250,770.68 m²**

DPZHK gjatë peridhes janar-qershor/2023 ka bashkëpunuar ngushtë me donatorët, konsulencën dhe akterët tjerë të involvuar për projekte konform Planit zhvillimor/strategjik të ndërmarrjes.

Projekti për Zgjërim dhe Rehabilitim të Rrjetit të Ngrohjes Qëndrore, si donacion i kfW dhe në bashkëfinancim edhe me NP Termokos, është i ndarë në dy pako tenderuese, T1 dhe T2.

Projektet

Kontrata T-1, MZ ID 201667575 / Procurement No. 505734 Supply and Installation of Heat Storage, Thermal Substations, Chemical Water Treatment and SCADA
Vlera e kontratës : 7,784,573 €,
Vlera e kontratës, pas shtesave : 8,029,936 €
Kontraktor : JV Brunata & ERGOTEM

Me këtë kontratë është planifikuar ndërtimi i 320 nënstacioneve të reja në pjesën që i përket zgjerimit të rrjetit, dhe rehabilitimi i 270 nënstacioneve ekzistuese. Pjesë e projektit është edhe ndërtimi i rezervuarëve të nxehtësisë me kapacite 2x400m³, integrimi i këtij sistemi në SCADA si dhe rehabilitimi i sistemit për mbajtje të shtypjes në rrjetin shpërndarës.
Kontrata për këtë pako tenderuese është nënshkruar në fund të dhjetorit 2021.
Në kete gjashtemujor jane kryer keto pune:

- Janë instaluar 72 nënstacione;
  - 69 nenstacone te reja,
  - 13 nenstacione te rehabilituara,
- Në pjesën e projektit që I referohet Rezervuarëve të nxehtësisë, punët përgaditore në teren kan filluar në fillim të marsit. Nw kwtw periudhw janë kryer këto punë:
  - Nga ana e kontraktorit Ergotem është organizu punishtja;
  - Është furnizu një pjesë e materialit për rezervuar, kapakët fundorë dhe të epërm dhe pllakat.
  - Janë instaluar unazat e bazamentit për të dy rezervuarët,
  - Janë instaluar pllakat pwr tw dy rezervuarwt deri nw nivelin e fundit,
  - Janë furnizuar disa prej pajisjeve të planifikuara me project:
    - Pompa e sistemit të kogjenerimt 1600m³/h,
    - Pompa e rrjetit 860m³/h,
    - Motorët 315kW, 2 copë, për pompat ekzistuese;

Kontrata T-2, Project: "Improvement of District Heating System Pristina", Contract 2 - supply and installation of DH pipes, BMZ ID 201667575
Vlera e kontratës: 4,349,630.52 €;
Vlera Totale e projektit, pas Shtesave te pranuara: 7,238,257.00 €
Kontraktor : ALL ZONE LLC

Me këtë kontartë është e planifikuar instalimi i rrjetit në pjesët e qytetit ku planifikohet zgjerim dhe densifikim i rrjetit të ngrohjes qëndrore, si dhe rehabilitim i segmenteve të caktuara të rrjetit ekzistues. Kontrata me kontraktorin ALL ZONE është nënshkruar në fund të dhjetorit të vitit 2020, ndërsa punimet konkrete ne teren kan filluar në fillim të majit të vitit 2021.
Brenda kësaj periudhe janë kryer punime në zgjërim të rrjetit në lagjen Arbëria dhe lagjen Qendër (CEE). Në tabelën në vijim janë dhënë sasit e gypave të instaluar në këto dy lagje.

Në periudhen raportuese janë instaluar gypa në pjesën për rehabilitim dhe zgjerim të rrjetit:
Tabela 33. Rehabilitimi i rrjetit

nr	Pershkrimi	Trase, L (m)	Gyp L (m)
1	Total trase dhe gyp i instaluar - zgjerim (m)	2908	5816
2	Total trase dhe gyp i instaluar - rehabilitim (m)	1134	2267
3	**Total trase dhe gyp i instaluar - zgjerim + rehabilitim (m)**	**4042**	**8083**

Edhe për këtë pjesë të projektit, përveq takimeve të rregullta teknike javore, jan mbajtur edhe 3takimet mujore të progresit.

Projekti i matësve të energjisë :

Supply, Installation, Maintenance of relevant equipment and services for the introduction of consumption based heat metering and thermostatic heating valves in District Heating, Prishtina.
Kontrata për këtë projekt është nënshkruar në Prill 2022, në mes të MFK (Millenium Foundation-Kosova) dhe kontraktorit "ENERCO LLC" Sh.P.K – Prishtinë dhe ka filluar së zbatuari me 27.07.2022.
Pas Nëntorit të vitit 2022 është bërë një ndryshim dhe riorganizim në project. Bazuar në Marrëveshjen Trepalëshe në mes të MCC, Komunës së Prishtinës dhe Termokosit, projekti kalon në përgjegjësi të Termokosit. Fondet e mbetura, me shtesë prej 2,000,000.00 nga Komuna e Prishtinës dhe 1,000,000.00 nga Termokosi, menaxhohen nga PIU e këtij projekti e cila deri në fund të projektit është pjesë e Termokosit.
Për shkak të këtij riorganizimi dhe faktit se kemi qenë në sezonë të nxemjes, sa I përket këtij projektoi në këtë tremujor nuk ka patur asnjë progres në teren. Prandaj, gjendja aktuale është e njejtë me gjendjen e raportuar në Raportin e vitit 2022.

Deri më tani janë instaluar këto pajisje:

	Banesa	Banes ate perfunduara	Valvola dykahore	Valvola trekahore	HCA	TRV	Mates energjie	Pompa qarkulluese
ULPIANA	2462	1627	5816	3	6049	5819	0	2
DARDANIA	6027	3177	16039	0	14766	15309	0	0
QENDRA	3330	1904	8599	745	8601	9355	180	44
KALABRIA	2075	1301	5514	789	2333	6303	414	0
KODRA E DIELLIT	4573	3011	13646	463	8734	14109	76	9
TOTAL	18467	11020	49614	2000	40483	50895	670	55

Projekti i Solar4Kosova II

Projekti i solareve është në fazën finale të studimit të fizibilitetit. Projekti VNMS (Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social) , i punuar nga CES-iC dhe financuar nga KFW, është në fazën përfundimtare.
Ndërkohë janë përpiluar ToR për kompaninë konsulente të Projektit. Këto kritere, me komente, jan aprovuar nga Termokosi dhe I jane dërguar tri kompanive të cilat janë në garë për konsulencë të këtij projekti. Ofertat duhet te happen me 28.07.2023

Projekti për dyfishim të kapaciteteve

Me 17.06.2022 është nënshkruar marrëveshja në mes të Bankës Europiane për Investime (EIB) dhe Termokosit, për projektin për dyfishim të kapaciteteve të energjisë termike të ekstraktuar nga TE Kosova B. BEI ka da një grant në vlerë prej 1,500,000.00 euro për financimin e studimeve paraprake për këtë projekt.

- Kompania ERI-ITA është zgjedhur si konsulencë për studim të fizibilitetit për projekt. Në fund të viti 2022 (nëntor dhe dhjetor) jan mbajtur disa takime në të cilat kryesisht kemi dhënë informata dhe dokumentacion teknik sipas kërkesave të kësaj kompanie.
- Vazhdojnë konsultimet me këtë kompani. Bashkëpunimi konsiston në dhënjen e shënimeve teknike dhe prezentimin e kërkesave nga ana e Termokosit.

Në këtë periudhë jan mbajtur tri takime mujore kordinuese me kompaninë ERI-ITA. Kompania, me 21.03.2023, ka prezentuar para bordit të ndërmarrjes Draftin e projektit për dyfishim të kapaciteteve dhe të projektit për dekarbonizim. Kompania është në fazën ne rekrutimit të stafit të nevojshëm profesional për projekt.
Kompania konsulente ka plotesuar ekipin me staf lokal, i cili i eshte aprovuar edhe nga donatori.

DEPARTAMENTI I FINANCAVE

Departamenti i Financave ka planifikuar, organizuar, drejtuar dhe kontolluar aktivitetet financiare, të kontabilitetit, auditimit apo shërbimit tjetër financiar.

Menaxhimi dhe raportimi i të hyrave dhe shpenzimeve në harmoni me ligjet e aplikuara dhe standardet e kontabilitetit, sigurimi i informatave financiare dhe kualitative për palët e interesuara si dhe aktivitetet tjera financiare janë po ashtu pjesë përbërëse e menaxhimit financiar të realizuara gjatë periudhes raportuese.

Gjatë periudhës raportuese, në Departamentin e Financave janë kryer të gjitha punët sipas procedurave dhe përgjegjësive të caktuara. Janë bërë raportimet e rregullta mujore, tremujore.


Gjatë peridhes janar-qershor 2023, ndërmarrja ka realizuar fitim Neto në vlerë prej **Eur 1.64 mil.**

Sipas pasqyrës së rrjedhës së parasë, NP Termokos" Sh. A. ka pasur një likuiditet të mjaftueshëm përgjatë periudhës raportuese janar-qershor 2023.

Tabela 34. Të hyrat nga shërbimet e ngrohjes gjatë periudhës janar-qershor 2023 sipas sektorëve

Sektori	Amvisërisë	Afarist	Total inkasimi
Inkasimi ne janar-qershor 2023	3,174,022 €	2,779,298 €	5,953,319 €

Figura 15. Inkasimi në janar-qershor 2023, sipas sektorëve




Total inkasimi në janar-qershor 2023 është 5,953,319 €. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, inkasimi në periudhën janar-qershor 2023, ka shënuar rritje për 19.6 %, respektivisht për 977,159 €.

Tabela 35. Inkasimi sipas sektorëve për janar-qershor 2023 krahasuar me inkasimin ne janar-qershor 2022

Sektori	Inkasimi janar-qershor 2023	Inkasimi janar-qershor 2022	Janar-qershor/2023- Janar-qershor/2022	
			Eval. (€)	Eval. (%)
Amvisëri	3,174,021.96 €	2,340,985.88 €	833,036.08 €	35.58%
Afarist/Institucional	2,779,297.53 €	2,635,174.84 €	144,122.69 €	5.47%
Totali	**5,953,319.49 €**	**4,976,160.72 €**	**977,158.77 €**	**19.64%**

Sqarim: vlerat e parqitura janë pa TVSH.

Figura 16. Inkasimi sipas sektorëve për periudhen janar-qershor 2023 - krahasuar me inkasimin në janar-qershor 2022



TË ARRITURAT

Në janar-qershor 2023, krahasuar me janar-qershor 2022 është arritur:

- Rritje e faturimit 22%;
- Rritje e inkasimit 19.6%;
- Rritje e numrit të konsumatorëve 30.2%
- Rritje e sipërfaqes ngrohëse 23 %
- Zvogëlim i humbjeve të ujit në rrjetin e shperndarjes –15.7%
- Përparim në konsolidimin e departamenteve të reja;
- Progres në realizimin e Projekteve për zgjerim të rrjetit;
- Ngritja e shkallës së qëndrueshmërisë afariste të ndërmarrjes;

SFIDAT

Gjatë punës janar – qershor 2023 sfidat më të mëdha kanë qenë:

- Ngritja e inkasimit;
- Arkëtimi i borxheve të vjetra të trashëguara;
- Ngritja e cmimeve, gjë e cila ka ndikuar në realizimin e projekteve ekzistuese dhe fillimin e projekteve te reja
- Implementimi i rekomandimeve nga Zyre Kombetare e Auditimit
- Procedurat e brendëshme të Departamenteve.

OBJEKTIVAT

Vazhdimi i ofrimit të shërbimeve të ngrohjes së qëndrueshme dhe kualitative për konsumatorët ekzistues dhe ata që do kyçen;

- Realizimi i projekteve tjera në kuadër të Projektit të Koogjenerimit.
- Vazhdimi i reformimit të shërbimeve të administratës;
- Ngritja e nivelit të kontrollit të brendshëm;
- Vazhdimi i rehabilitimit dhe modernizimit të rrjetit të ngrohjes;
- Vazhdimi i zgjerimit të rrjetit konform Masterplanit;
- Instalimi i njehsorëve digjital për konsumatorët e sektori të amvisërisë;
- Fillimi i faturimit të konsumatorëve banesorë bazuar në energjinë e shpenzuar;
- Intensifikimi i bashkëpunimit me organet komunale dhe qendrore;

MASAT PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE TË NDËRMARRJES

Me qëllim të realizimit të objektivave të saj gjatë vitit 2023, siç janë qëndrueshmëria financiare e ndërmarrjes, ofrimi i ngrohjes më kualitative për qytetarët, reformimi dhe modernizimi i administratës, rritja e arkëtimit përfshirë edhe borxhet, realizimi i Projektit të Koogjenerimit e tjera, janë paraparë këto masa:

- Ulja e mëtutjeshme e shpenzimeve operacionale;
- Kompletimi i akteve të brendshme administrative;
- Rehabilitimi teknik i rrjetit të distribuimit dhe njësisë së prodhimit;
- Zbatimi i masave operacionale për ngritjen e arkëtimit përfshirë edhe borxhet;
- Intensifikimi i puhëve në realizimin e Projektit të Koogjenerimit.

Kryeshef Ekzekutiv

Fisnik Osmani

KONTAKTI

NP Termokos Sh.A.


Rr. 28 Nëntori nr.181, Prishtinë

Telefon : 038 543-210,

Fax : 038 541-780,

Mobil : 044 555-680,

E mail : info@termokos.net



Termokos

Ngrohtorja e qytetit

© N.P. Termokos Sh.A.

www.termokos.com